



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 54, datë 28.05.2025

P Ë R

KORRIGJIMIN E DOKUMENTIT TË RREGULLORES SË VEÇANTË
BASHKËLIDHUR VENDIMIT NR.20, DATË 24.12.2024 TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TERRITORIT “PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: “OBJEKT ME FUNKSION HOTEL, BANIM, ZYRA DHE SHËRBIME,
35 KATE MBI TOKË, ME 6 KATE NËNTOKË”, ME VENDODHJE NE BASHKINË
TIRANË

Në mbështetje të Nenit 112 “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e Dokumentit të Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr.20, datë 24.12.2024 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Objekt me funksion hotel, banim, zyra dhe shërbime, 35 kate mbi tokë, me 6 kate nëntokë, me vendodhje ne Bashkinë Tiranë”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k, sipas Dokumentit të Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të gjithë kushtet e tjera të Vendimit Nr.20, datë 24.12.2024, mbeten të pandryshuara.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 26/06 2025